(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësinë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj: **Materiali me PDF**

Specifikimi i Materialeve: **Materiali me PDF**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: **Materiali me PDF**


Shtojca 6.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 16 muaj



Materiali ne PDF

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor **për kestet e maturuara te vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

2.3 Kapaciteti teknik:

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është në një vlerë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë të cilët kanë përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

-
- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fature tatimore perkatëse të deklaruar në organet tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi në tokë”/ **EKUIVALENTE**

Kategoria NP-2 Niveli D “Ndërtime civile dhe industriale.” / **EKUIVALENTE**

Për punimet speciale të ndërtimit :

- Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimev”/ **EKUIVALENTE**
- Kategoria NS-2 Niveli A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”/ **EKUIVALENTE**

- Kategoria NS-3 Niveli A “ Impiante ngritëse dhe transportuese(ashensorë,shkallë lëvizëse, Transportues” / **EKUIVALENTE**
- Kategoria NS-4 Niveli B “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.” / **EKUIVALENTE**
- Kategoria NS-12 Niveli B “Impiante teknologjik termik ... “ / **EKUIVALENTE**
- Kategoria NS-14 Niveli B “ Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV” / **EKUIVALENTE**
- Kategoria NS-18 Niveli A “ Punime Topogjeodezike.” / **EKUIVALENTE**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me

- a. Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme"
- b. Licence I.2.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile" per sistemet e ekspertizes teknike kundra zjarrit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet te disponohen nga nga anetari qe do te kryejë shërbimet perkatese).

Vendimi Nr. 724, date 20.11.2024 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr. 805, datë 20.12.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për Licencat Dhe Lejet Që trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të përbashkëta”, si dhe të konsultohet me faqen e QKB në lidhje me informacionin mbi licencat dhe lejet.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni 8**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtnuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtnuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunitimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, ***drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese***, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 2(dy)
 - Inxhinier Ndertimi profili Strukturist 1(një)
 - Inxhinier Elektrik 1(një)
 - Inxhinier Mekanik 1(një)
 - Inxhinier Hidroteknik 1(një)
 - Inxhinier Elektronik 1 (një) /edhe me **kontratë bashkëpunimi**.
 - Inxhinier Gjeodet 1 (një)
 - Arkitekt 1(një)
- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*), librezë pune, C.V.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.6 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe ***stafin mbështetës*** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1(një)
- Inxhinier Elektrik 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Arkitekt Peisazhi 1(një)

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*)/kontrate bashkëpunimi, librezë pune, C.V.

2.3.7 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) person, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve / Produkteve të Ndërtimit / Inxhinier Materialeve.**

Personi i mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme/ ose me kontratë bashkepunimi , Diplomë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar, / ose dhe me kontratë Bashkëpunimi** si më poshtë:

- **1 (një) inxhinjer si “Ekspert zjarrfikës”** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/dëshmi per ekspert zjarrfikës te lëshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata e punes si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryejë punimet e MNZ.*
- **2 (dy) Punonjes Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I. / ose dhe me kontratë Bashkëpunimi** Renia nga lartesia, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Një punonjës i Certifikuar si Kordinator I sigurise gjate fazes se punimit ndertimit ne kantier / **ose dhe me kontratë Bashkëpunimi** . Certificate kordinator per sigurine ne pune. Certificate nga kryqi I kuq "Per dhenien e ndihmes se pare, ndimes se shpejt ", kontratë pune e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht **90 (nëntëdhjete)** personave, mesatarisht për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr. 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve” për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Shenim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagese për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit., me profesionet si mëposhtë:

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
 - Teknik ashensori 1 (nje)
 - Specialist IT 1 (nje)
 - Elektracist 3 (kater)
 - Hidraulik 2 (dy)
 - Specialist te sistemit te kondicionimit ngrohes-ftohes 2 (dy)
 - Muratore & Suvatues 7 (shtate)
 - Bojaxhinj 4 (kater)
 - Punime durale 1 (nje)
 - Punime gipsi 1 (nje)
 - Betonues 8 (tete)
 - Karpentier 6 (gjashte)
 - Hekurkthyes 5 (pese)
 - Pllakashtrues 3 (tre)
 - Hidroizolues 2 (dy)
 - Specialist konstruksione metalike 1 (nje)
 - Mekanik 1 (nje)
 - Saldator 2 (dy,) me deshmi TIG), i certifikuar nga autoritet shqiptare ose te huaja te akredituara
 - Punonjës të thjeshtë 15 (pesëmbëdhjetë)
- të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë .
 - Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shenim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fytuesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht :

- **3 punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda (2 automakinist dhe 1 eskavatorist) .
- **2 shofer kamioni**.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. *(Manovratorët mund të disponohen së bashku me mjetet perkatese nese merren me qira).*

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B , operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për pajisjet e meposhtme. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet edhe marreveshja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

Ashensor, Certificate per ashensorët e personave sipas standartit SSH EN 81-20:2020 dhe direktives 2014/33/EU e lëshuar nga organe të akredituara kombetare ose nderkombetare. Certifikata të shoqerohet bashke me certifikaten e akreditimit të organit të akredituar.Katalogu ose fragmente të katalogut

*Transformator 10- 20 / 0.4 kV - 2500kVA me regullator tensioni
Te paraqitet certifikate/deklarate nga prodhuesi që verteton që transformatori plotëson standardet SSH /IEC 60076 - Sistemet standarde për transformatorët e fuqisë.
Katalogu ose fragmente të katalogut*

2.3.13 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim / kontrate bashkepunimi nga prodhuesi / distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje / mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.14. Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten:

1. PUNIMET ELEKTRIKE

Kabell FG16OR16 Kabllot FG16OR16-0,6/1 duhet te jene sipas standardevSSH/e: CEI 20-13 SSH/IEC 60502-1 ose ekuivalente, SSH CEI UNEL 35318-35322-35016 ose ekuivalente; SSH /EN 50575:2014 + SSH /EN 50575/A1:2016 ose ekuivalente. Fleksibiliteti i bakrit duet te jete i klasit 5. Tensioni nominal U0 duhet te jete 600V (AC). Tensioni nominal U duhet te jete 1000V(AC). Tensioni i tetimit duhet te jete 4000V. Tensioni maksimal Um duhet te jete 1200V(AC). Temperatura maksimale e operimit duhet te jete 90 °C. Temperatura maksimale e lidhjes se shkurter duhet te jete 250 °C per seksione deri ne 240mm2 Temperatura minimale e operimit duhet te jete -15 °C. Forca maksimale ne terheqje nuk duhet te jete me pak se 50N/mm2. Duhet te paraqiten: **Skedat teknike/kataloge te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar ose certifikata aprovimi/performance .**

PUNIME BOJATISJE

Boje Hidroplastike ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.**

PUNIME SHITESH, SUVATIMI DHE VESHJE

Hidroizolues Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të

papërshtueshme nga uji. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me SSH /ISO 17025 ose ekuivalente.**

Pllakë shtrimi grez porcelanato. Porcelain . Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmanget rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi .**

Veshje me pllakë majolike. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

Suva (Llac mbushës)- Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me SSH/ ISO 17025 ose ekuivalente**

Fino Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1 ose ekuivalente. Duhet te paraqiten: **Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me SSH/ ISO 17025 ose ekuivalente.**

PUNIME HIDRAULIKE.

Tuba PPR Tubat PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer) . Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te cilet ndikojne ne ndryshimet sasiore dhe vetite e materialit si fleksibiliteti dhe fluiditeti .Tubat duhet te jene te prodhuara sipas SSH EN ISO 15874-3 ose ekuivalente dhe te afta per te perballuar presione deri ne 25 bar ose 2.5 MPa. Dendesia e materialit Sipas standartit : SSH ISO 1183 ose ekuivalente. Elasticiteti I tubit sipas:ISO 527-2/1 ose ekuivalente. Fortesia e tubit sipas : SSH ISO 865 ose ekuivalente. Rezistenca ndaj goditjeve sipas: SSH ISO 179 ose ekuivalente. Percueshmeria termike sipas:DIN 52612 ose ekuivalente. Tubat PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certikuar me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). **Duhet te paraqiten: Kataloget/ skedat**

PUNIME HIDROSANITARE.

WC duhet te jete e perbere prej porcelani cilesor. Materiali duhet te jete rezistent ndaj gershitjeve. Lartesia te jete nga 50- 70 cm , gjeresia te jete 30-40 cm.WC duhet te permbushin kerkesat funksionale dhe metodat e testimit sipas standartit SSH EN 997 2012 ,rezistencen e ngarkeses,pastrueshmerin,qendrueshmerin shkallen e rrjedhjes sipas normes SSH EN 997 2012 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

Lavaman Lavamani ngjyre e bardhe. Materiali porcelan. Te jete me lartesi 800-900mm. Te kete gjeresi maksimalisht 600mm dhe gjatesi minimalisht 650mm. Pjesa e montimit te behet me ane te dy vrimave me largesi 280mm. .Lavamanet duhet te permbushin kerkesat funksionale ,rezistenca e ngarkeses,pastrueshmeria,qendrueshmeria shkalla e rrjedhjes sipas normes SSH EN 14688 ose ekuivalente Duhet te paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike te shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi .**

Boljer Ngrohësit e ujit duhet të jenë të përshtatshëm për të plotësuar të gjitha kërkesat për ujë dhe ngrohje të mundësojnë instalimin e tyre kudo horizontal dhe vertikal me një rrymë 220-240 V AC. Shtresa e jashtme të jetë e fortë dhe rezistenca e ngrohjes së ujit çeliku inoxi Klasa ERP:CI pajisur me valvul presioni deri në 6 bar, tregues të nivelit të temperaturës, tregues i dritës ndezje/fikje, regjistrim manual i temperaturës. Duhet të paraqiten: **Kataloget/ skedat teknike të shoqëruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 5-10 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me kove 0.25m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma me kove para mbrapa	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrom	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Nivelues betoni helikopter	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	1 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri fasade	3000m2	Pronësi ose me qera
Makine për ngjitje tubash	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat elektrofuziv	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje për hekurkthyes (tranxhe, elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kapese për lidhje hekuri	2 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 90 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë

-
- Uniforma / Jelek pune 90 cope
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.
- f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Sqarim për specifikimet teknike bashkelidhur DST nga AK me të dhenat si më poshtë **Sqarojmë se AK do të lërë mundësinë e paraqitjes edhe të SSH ndër të tjera AK ka kërkuar standarde europiane si: "EN 12735-1; CEI EN 61439-3; IEC 60754-2:2011; IEC 60755; IEC 60871; IEC 60947-1; IEC 60947-2; DIN 18015-1:2018 etj (konsultohuni me faqen zyrtare të DPS), lidhur me të gjitha specifikimet teknike të bashkalidhura në DST**

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____ ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

